



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VI

Sesioni Pranveror
Komisioni për Integritim Evropian
Mbledhja nr. 35.
Prishtinë, më 28.01.2019 në orën 9:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 302

PROCESVERBAL

Në mbledhje të Komisionit për Integritim Evropian morën pjesë: Blerta Deliu-Kodra, Armend Zemaj, Fikrim Damka, Ismajl Kurteshi, Fatmire Kollçaku, Visar Ymeri, Ismet Beqiri, Zenun Pajaziti, Donika-Kadaj-Bujupi dhe Milaim Zeka.

Mungoi: Adem Hoxha.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Ahtere Loxha, Adelina Demolli, Safet Beqiri dhe Florent Mehmeti.

Mbledhjen e kryesoi Blerta Deliu -Kodra, kryetare e komisionit

Kryetarja e Komisionit pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë e hapi mbledhjen e komisionit me këtë:

Rend Dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 18.12.2018;**
- 3. Miratimi i Raportit të punës së Komisionit për Integritim Evropian për vitin 2018;**
- 4. Shqyrtimi i draft- Planit të Punës së Komisionit për vitin 2019;**
- 5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-133 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**
- 6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-091 për plotësim-ndryshimin e Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**

7. Të ndryshme.

1. Miratimi i Rendit te Ditës

Rendi i ditës u miratua i pa ndryshuar.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur 18.12.2018.

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më **18.12.2018**, u miratua pa vërejtje.

3. Miratimi i Raportit të punës së Komisionit për vitin 2018

Kryetarja tha se Raporti i Punës së Komisionit për vitin 2018, është një Raport në të cilin është pasqyruar puna dhe aktivitetet e komisionit për vitin 2018.

Andaj hap diskutimin.

Pasi nuk kishte diskutime nga anëtarët lidhur me raportin, ftoj anëtarët që të njëjtin ta votojnë.

Pas votimit **kryetarja** konstatoj se komisioni një zëri nxori këtë;

Rekomandim

Miratohet Raporti i Punës së Komisionit për Integritet Evropian për vitin 2018.

4. Shqyrtimi i Draft - Planit të Punës së Komisionit për vitin 2019

Kryetarja lidhur me Draft planin e punës së Komisionit për Integritet Evropian për vitin 2019 tha, të premtën e kaluar, të gjithë kemi punuar bashkërisht, dhe në këtë plan janë përfshirë aktivitetet, objektivat dhe propozimet që kishim. Andaj hapi debatin.

Fatmire Kollçaku tha se e përkrah në parim raportin, por me kusht që gjatë punës të plotësohet me pika shtesë, e dini se kam pas vërejtje se ky komision ka qenë i anashkaluar, kryesisht nga Kryesia e Kuvendit, sepse nuk kemi qenë të përfshirë në procesin e lobimit dhe për më tepër nuk kemi qenë as të informuar. Kërkesa është nëse shkohet në ndonjë shtet për vizitë, qoftë kryetarja apo nënkryetarët që ka të bëjë me punën e Komisionit të na raportohet në komision lidhur me vizitën, sepse nuk po jemi në dijeni se çka po ndodh.

Të intensifikojmë punën për liberalizimin e vizave dhe ky komision ta ketë rolin prijës, ta realizojmë planin duke e pasur parasysh rolin tonë, si komision dhe mos të lejojmë që edhe tani e tutje të anashkalohejmë. Kurse vizita në Kroaci e paraparë në plan, të realizohet në mars e jo në maj, sepse duhet të planifikojmë vizita në rajon dhe të marrim model se si kanë arritur në procesin e lobimit, në veçanti në procesin e liberalizimit të vizave.

Kryetarja tha se në takimin e së premtes, kur e kemi diskutuar planin e punës janë vetëm disa korniza që janë vendosur brenda planit dhe ky plan mund të përmbushet gjatë agjendës sonë që do ta kemi në ditët në vijim, jemi dakorduar që bashkëpunimi rajonal me qenë me theks të veçantë, takimet me komisionet në rajon të jenë prioritet dhe për MSA-në të merremi me kapituj veç e veç dhe të shikojmë se cilat institucione, po ngecin t' i kryejnë obligimet karshi marrëveshjes. Njoftoj se delegacioni i MSA-së do ta ketë një takim në Strasburg, prej dt.12-15 shkurt.

Milaim Zeka u ndërlidh ne diskutimin e deputetes Kollçaku dhe tha se të njëjtat vërejtje kishte paraqit në takimin e së premtes, dhe shumica jemi pajtuar se më tepër kemi qenë komision statik dhe kamë thënë se nuk e di pse kam qenë anëtar i këtij komisioni.

Kemi biseduar ndër tjera që me u fokusua në vendet që nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës dhe me bërë një vizitë në Rumani, Spanjë dhe Greqi dhe me lobuar.

Pas diskutimeve **kryetarja** e hodhi në votim dhe konstatoj se komisioni një zëri nxori këtë:

Rekomandim

Miratohet Plani i Punës së Komisionit për vitin 2019.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-133 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryetarja tha se kemi për shqyrtim projektligjin mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Kosovës, si dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL.

Komisioni FunkSIONAL lidhur me këtë projektligj ka propozuar një numër shumë të madh të amendamenteve.

Konstatoj se fushëveprimi i projektligjit për ndarjet buxhetore nuk rregullohet me legjislacion të BE-së, rrjedhimisht as amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL, pra, është kompetencë e brendshme e secilit shtet të BE-së që këtë fushë ta rregullojë sipas kompetencave të tyre të brendshme.

Hapi diskutimin.

Pasi nuk kishte diskutues të paraqitur **kryetarja**, e hodhi ne votim Projektligjin së bashku me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL.

Pas votimit **kryetarja** konstatoj se komisioni me shumicë votash nxori këtë;

Rekomandim

Projektligji nr. 06/L-133 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019, me amendamentet e Komisionit Funkcional nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe si i tillë mund të rekomandohet për miratim në Kuvend.

6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-091 për plotësim-ndryshimin e Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryetarja tha se Projektligji për plotësim-ndryshimin e Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës ka për qëllim të rregulloi mënyrën e gjykimit në mungesë të krimeve të luftës në Kosovë përmes 20 neneve të Kodit të Procedurës Penale.

Ju njoftoi se ky projektligj është kërkuar edhe nga zyrtarët e BE-së në Kosovë, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, andaj mund të rekomandojmë për shqyrtim të mëtutjeshëm.

Hapi diskutimin

Pasi nuk kishte diskutues të paraqitur **kryetarja** e hodhi në votim Projektligjin së bashku me amendamentet.

Pas votimit kryetarja konstatoj se komisioni me shumicë votash nxori këtë;

Rekomandim

Projektligji nr. 06/L-091 për plotësim-ndryshimin e Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, me amendamentet e Komisionit Funkcional nuk është në kundërshtim me Legjislacionin e BE-së dhe si i tillë mund të rekomandohet për miratim në Kuvend.

7. Të ndryshme

Ismajl Kurteshi kërkoi që në komision të caktohet një ditë, siç ishte i caktuar për mbledhjet e komisionit, ta caktojnë një ditë që të dihet paraprakisht, për ta rregulluar orarin, që i përgjigjet kohës së vijimit edhe në këtë komision. Sipas tij këto ndryshime në mbajtjen e mbledhjeve po shkaktjnë probleme, sepse ndodh që caktohen mbledhje në të njëjtën kohë edhe në komisionin tjetër të grupit parlamentar dhe pastaj njëren mbledhje po duhet me u humb.

Kryetarja sqaroi se të premtën kur e kemi caktuar kohën për mbajtjen e takimit për shqyrtimin e planit të punës së Komisionit, 3 deputetë nuk kanë qenë dhe nuk mundeshin me aritur me kohë, andaj u detyruam ta shtyjmë kohën e mbajtjes së mbledhjes, por paraprakisht kemi bërë kërkesë nëse ka dakordim të shtyhet për orën 13:00.

Po ashtu edhe sot është dashtë të caktohet më herët mbledhja, sepse në shqyrtim është buxheti dhe 3 anëtarë të komisionit kanë me udhëtuar jashtë vendit. Prandaj kërkoj falje për këtë, për ndërrimin e terminit të zakonshëm për mbajtje të mbledhjes së komisionit.

Zenun Pajaziti tha se do të ishte mirë që me kërkuar nga Kryesia e Kuvendit dhe grupet parlamentare që në Komisionin për MSA-në të jenë të përfshirë të gjithë anëtarët e Komisionit për Integritet Evropian, për hir të koordinimit sa më të mirë të aktiviteteve të komisioneve dhe me pasur sa më shumë fokusin, me pasur në MSA-në dhe agjendën e Integriteteve Evropiane.

Visar Ymeri u ndërlidh në diskutim dhe tha se kur është themeluar komisioni i përbashkët në Parlamentin Evropian, në diskutime kanë qenë dy lloj idesh, por ka mbizotëruar ideja që në atë delegacion apo komision, si po e quajnë, me synua me dërgua sa me tepër kryetar komisionesh në mënyrë që përgjegjësit që dalin prej MSA-së, që janë gjithëpërfshirëse me u shndërruar në një agjendë serioze nëpër komisionet e Kuvendit, por sidoqoftë vendimmarrja i mbetet grupeve parlamentare se kënd e dërgojnë në atë delegacion. Natyrisht këto sugjerime janë dhënë dhe nuk mendoj se është përgjegjësi e komisionit tonë ta bëjmë një gjë të tillë duke i pas parasysh specifikat e atij delegacioni, por do të ishte mirë që ashtu, si kemi biseduar të premtën, me e marrë agjendën e MSA-së dhe me bërë pjesë të agjendës sonë dhe në bashkërendim me atë delegacion në të cilin një pjesë e anëtarëve janë edhe aty dhe kjo do të ishte ajo puna lidhëse mes atij delegacionit dhe komisionit tonë. Andaj mendoj se së shpejti do të duhej të përcaktojmë për secilin muaj nga një kapitull të MSA-së dhe ta shqyrtojmë hollësisht nivelin e zbatueshmërisë, arsyet e ngecjeve dhe koordinimin institucional nëse mungon.

Është e rëndësishme që pjesë e delegacionit me qenë edhe kryetarët e komisioneve, në mënyrë që të përfaqësohen të gjitha komisionet e Parlamentit që merren me fusha specifike, sepse MSA mbulon më shumë fusha se sa ato që mund të shihen si pjesë e agjendës evropiane.

Zenun Pajaziti tha se për afërsisht ishte edhe ky qëllimi im me pasur sa më shumë përfshirje, ne duhet të fokusohemi më tepër në MSA dhe pjesa kryesore e punës sonë është dokumenti i MSA-së, sa më shumë përfshirje mendoj, sa ma shumë ish aktivizuar edhe komisioni i MSA-së dhe me e pasur rolin monitorues në mbikëqyrjen e zbatimit të detyrave që dalin nga MSA.

Kryetarja tha se po ndërlidhem me atë që e tha edhe Visari, neni 132 i MSA –së e thotë saktë që me këtë marrëveshje themelohet Komisioni Parlamentar për Stabilizim-Asociimit dhe është forum i anëtarëve të Parlamentit Evropian dhe anëtarëve të Parlamentit të Kosovës për t'u takuar dhe shkëmbyer mendimet e tyre, ai do të mbledhet në intervale kohore që vendoset nga vetë ata, por të paktën një herë në vit. Ne, në takimin e fundit jemi dakorduar me pasur një koordinim më të mirë me kryetarët e komisioneve parlamentare veç e veç dhe meqë puna e vizave më nuk është në dorën tonë, fokusi i komisionit tonë, përveç agjendës së integriteteve evropiane dhe fondeve të

destinuara për BE-në do ta ketë fokus kryesisht implementimin dhe zbatimin e MSA-së dhe besoj me kapitujt veç e veç do të arrijmë që te ministritë e linjës të kemi një rol se ku janë sfidat që kjo marrëveshje të ketë një përqindje më të madhe të implementimit.

Mbledhja përfundoi në orën 9:30.

Përgatitur nga
Njësia për mbështetjen e komisionit

Kryetare e komisionit,

Blerta Deliu-Kodra